

Faqja e Gazetës "USHTRIA", Kryeredaktor: Bardhyl Gostnishi



Botim Qëndror i
Ministrit të Mbrojtjes

Gazeta

USHTRIA

Ministria e Mbrojtjes ▶ Botime ▶ Revista Mbrojtja

Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake

▶ Faqe e parë
▶ Misioni
▶ Legjislacioni
▶ Struktura
▶ Revista Mbrojtja
▶ Gazeta Ushtria
▶ Botime të reja
▶ Njoftime
▶ Kontakt
▶ Linke

Qendra e Shtypit,
Botimeve dhe
Përkthimeve Ushtarake

DREJTOR:
Ded Kola
tel: 226701/3099

Redaksia e **LIBRIT**

Kryeredaktor:
Mina QIRICI
tel: 226701/3099

VLERËSIMI

FA shqiptare, ndryshime cilësore dhe nivel i lartë profesional

Një delegacion i lartë i NATO-s, kryesuar nga Zëvendës Komandanti Suprem Aleat për Europën, Gjeneral Lejtnant Jon Reith viziton vendin tonë. Takime zyrtare me Presidentin Moisiu, kryeministrin Berisha, ministrin e Mbrojtjes Mediu dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së Gjeneral Lejtnant Qazimi: Reith: "NATO e gatshme për të ndihmuar në arritjen e standarteve" >>>



SHBA, mbështetje në rrugën e antarësimit euro-atlantik

Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu priti ditën e hënë, në një takim të veçantë

SPECIALE

[Bunavia, shkolla për t'u bërë ushtar. 700 rekrutë nisin ciklin e ri stërvitor](#)

Mediu: Synojmë standarde cilësore

Është në nderin tim si ministër i Mbrojtjes që t'ju përhëndes e t'ju uroj me këtë rast sukses e faqe të bardhë në detyrën tuaj fisnike.

KDS

[Dimensioni i ri i marrëdhënieve](#)

Gazeta **USHTRIA**
Kryeredaktor:
Bardhyl Gostnishti

tel: 226701/3099

Revista **MBROJTJA**
Kryeredaktor:
Prof.Dr. Elmaz Leci

tel: 226701/3099

ambasadoren e SHBA-së në Tiranë Marcie Ries. Në takim ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneral lejtant Pëllumb Qazimi. Ambasadorja Marcie Ries, pasi i uroi zotit Fatmir Mediu detyrën e re si ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, vlerësoi punën që kanë bërë komandat ushtarake dhe strukturat e tjera të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm për reformimin e Forcave të Armatosura shqiptare dhe konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rrugën drejt arritjes së qëllimit parësor të vendit tonë, anëtarësimin në Aleancën euro-atlantike.

Moisiu: "Shqipëria, mirënjohëse ndaj kontributit të NATO-s"

Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, priti në një takim, ditën e martë gjeneral Reith, zv/komandant Suprem i Aleancës për Evropën, shoqëruar nga këshilltari politik i NATO-s në Tiranë, Iliopoulos, asistent i NATO-s në Tiranë, gjeneral lejtant Vito di Ventura etj. Në takim mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral lejtant Pëllumb Qazimi.

"Trupat shqiptare në "Engagement '05", shumë të suksesshëm"

"Këtë vit, stërvitja u krye në një mënyrë të shkëlqyer duke e arritur synimin me një sukses të madh", i shkruan mes të tjerash në mesazhin drejtuar shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë gjeneral lejtant Pëllumb Qazimit, komandanti i Komandës Detare pranë Komandës së Bashkuar të Forcave Aleate në Napoli, nënadmiralet R. Cesareti.

600 VJETORI, FLET SHABAN SINANI

Këtë vit mbërrin një Skënderbe tjetër

"Ushtria": Sa i rëndësishëm është viti përkujtimor i 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut për Shqipërinë?

Për herë të fundit një konferencë e madhe shkencore për Skënderbeun është zhvilluar në vitin 1968, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes.

Civilo-Ushtarake

Nis konkretizimi i urdhrat të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, për institucionalizimin e bashkëpunimit civilo-ushtarak, përmes krijimit të ekipeve të përbashkëta nga të dyja fushat.

FORCAT AJRORE

Filloi stërvitja e kërkim-shpëtimit "EAGLE SAR 05"

"EAGLE SAR '05", është një stërvitje e ndërtuar me një skenar të tillë që kërkon përgatitje të lartë të gjithë strukturave e personelit të kërkim-shpëtimit për kryerjen dhe realizimin e operacioneve të tilla sipas standardeve të NATO-s.

PORTRETE

Altin Hoxha,
[togeri që pikturon dhe pëlqen Kodrën e Van Gogun](#)

Spiro Mio,
[ushtari profesionist, boksieri që shërben për herë të dytë në Bosnje](#)

- **ARSIMIMI NE SHBA**
[Kualifikimet e ushtarakëve shqiptarë në akademitë amerikane, faktor i rëndësishëm i implementimit të](#)

- **ELBASAN**
[ULP Mjekës, furrë e re për djegien e municioneve](#)
[Mediu: "Vendi ynë, lider në fushëm e demilitarizimit"](#)

- [Vlerësohet bashkëpunimi ushtarak mes vendeve tona](#)
[Këtë vit mbërrin një Skënderbe tjetër](#)

[standardeve të NATO-s](#)

- [Apeli i Ministrit të Mbrojtjes](#)

Arkivi i Gazetës "USHTRIA"					
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
29.07.2005	26.08.2005	30.09.2005	07.10.2005		
22.07.2005	19.08.2005	23.09.2005			
	12.08.2005	16.09.2005			
	05.08.2005	09.09.2005			
		02.09.2005			

Gazeta e dates 07.10.2005



- ▶ Faqe e parë
- ▶ Misioni
- ▶ Legjislacioni
- ▶ Struktura
- ▶ Revista Mbrojtja
- ▶ Gazeta Ushtria
- ▶ Botime të reja
- ▶ Njoftime
- ▶ Kontakt
- ▶ Linke

Këtë vit mbërrin një Skënderbe tjetër

"Ushtria": Sa i rëndësishëm është viti përkujtimor i 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut për Shqipërinë?

Për herë të fundit një konferencë e madhe shkencore për Skënderbeun është zhvilluar në vitin 1968, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes. Ajo konferencë ka qenë e rëndësishme dhe e organizuar me një përgjegjësi shkencore të admirueshme. Por, për rrethana historike-politike, ajo ka pasur edhe kufizime e mungesa. Në këtë konferencë, bie fjala, nuk ishte e mundur që të merrnin pjesë studiues të disa shkollave të albanologjisë, si shkolla ruse, shkolla britanike dhe ajo amerikane, shkolla kroate, përfaqësues të Selisë së Shenjtë dhe të institucioneve në varësi të saj (Biblioteka Apostolica Vaticana, Archivio Segretto Vaticana). Megjithatë, në atë 500-vjetor Papa Pali VI pati shkruar një enciklikë (letër të hapur) drejtuar gjithë shqiptarëve, në të cilën ndër të tjera thuhet: "Skënderbeu është biri famëmadh i një treve që ka pasur fatin të përfshihet në hapësirën e udhëtimeve apostolike të shën Palit dhe ndoshta të marrë pikërisht prej tij për herë të parë "lajmin e mirë", Ungjillin. Shekulli i 15-të ka qenë për kombin shqiptar një prej kohërave më të rënda dhe njëherësh më të lavdishme të historisë së tij. Qendresa e shqiptarëve gjatë një 25 vjetëve u dëshmuua sa këmbëngulëse aq dhe fitimtare, në trimëri e strategji, nën udhëheqjen e kryeprijësit të tyre Gjergj Kastrioti - Skënderbeu". Këtë letër, përveçse "Osservatorio Romano", e pati botuar shqip edhe Koliqi, në revistën "Shëjzat", por në atë kohë as "Shëjzat", as radio Vatikani, nuk mund të arrinin deri tek njerëzit shqiptarë. A do të tejkalohen në këtë jubile të dytë, jubile vitlindjeje, jubile të gëzuar, mangësitë dhe kufizimet objektive të konferencës së organizuar në vitin 1968? A do të ketë sivjet një letër papnore për 600-vjetorin e lindjes së Skënderbeut? E kam të vështirë për të dhënë një përgjigje pozitive. Tani liria nuk mungon, por mungojnë disa autoritete të larta

Qendra e Shtypit,
Botimeve dhe
Përkthimeve Ushtarake

DREJTOR:
Ded Kola
tel: 226701/3099

Redaksia e **LIBRIT**

Kryeredaktor:
Mina QIRICI
tel: 226701/3099

Gazeta **USHTRIA**

Kryeredaktor:
Bardhyl Gostnishti

tel: 226701/3099

Revista **MBROJTJA**
Kryeredaktor:
Prof.Dr. Elmaz Leci

tel: 226701/3099

të mendimit dhe dijes. Nuk janë më në këtë jetë Aleks Buda, Eqrem Çabej, Injac Zamputi. Madje nuk jam i sigurt nëse në veprimtaritë shkencore të këtij jubileu do të marrin pjesë përfaqësues të atyre shkollave albanologjike, dikur të refuzuara, që sapo i përmenda. Ajo që mund të thuhet në mënyrë të sigurt është se sot ka shumë nisma me karakter shkencor-përkujtimor, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, që do të zhvillohen e realizohen pavarësisht se çfarë do të bëjnë bashkëvendësit e Gjergj Kastriotit. Shkrimtari italian Costanzo d'Agostino, njëherësh dhe një prej biografëve bashkëkohorë të Skënderbeut, ka një vit që kryeson një "Comitato di Cultura Europea", të krijuar pikërisht për të detyruar autoritetet e vendit të tij që "Palazzo Scanderbeg" të kthehet në funksionin që përputhet me emrin (jo muze makaronash, sikurse është tani), në nderim të 600-vjetorit të lindjes. Një konferencë jubilarë shkencore ndërkombëtare do të bëhet në fund të këtij viti nën kujdesin e Prof. Dr. Italo Costante Fortino në Universitetin e Napolit, departamenti i studimeve orientale. Dr. Bjoern Andersen, albanolog danez, në bashkëpunim me Bibliotekën Mbretërore të Danimarkës dhe me shumë dijetarë nga vendet nordike, midis të cilëve dhe etnologja Minna Jensen Skafe, ka propozuar një kalendar veprimtarish shkencore që zgjat dy vjet. Në Romë një redaksi e përbërë prej Tomaso Mrkonjic (kroat) dhe dy bashkëpunëtorët e tij shqiptarë Dr. Musa Ahmeti e Msc. Etleva Lala kanë përfunduar përgatitjen për botim të vëllimit të tretë të serisë së nisur nga Milan pl. Sufflay "Acta Albaniae", që i përgjigjet periudhës 1403-1450. Nisma të tilla, përveçse në Prishtinë e në Shkup, janë bërë të ditura dhe po presin realizimin edhe në SHBA, në Kroaci, në Greqi, në Hungari. Ky ndërkombëtarizim i veprimtarive i përgjigjet përmasës së vetë figurës së Gjergj Kastriotit. Pjesëmarrja e studiuesve të huaj, qoftë edhe në këtë formë debati, në distancë, është një akt emancipues në mendësinë shqiptare. Në kohën e sotme nuk mjafton të dëgjosh vetveten. 600-vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit është një rast i shkëlqyer për të dëgjuar të tjerët, duke përfshirë dhe kundërshtarët e tezave të albanologjisë vendëse. Pa pjesëmarrjen e tjetrit ky jubile nuk mund të quhet i plotë. Dija shqiptare nuk mund të bëjë përpara pa kapërcyer hendekun historik të mbylljes së syve dhe veshëve për çka thonë e shkruajnë fqinjët, grekët e serbët, po edhe turqit republikanë (jo vetëm kronikanët osmanë). Rasti i 600-vjetorit vjen si një shans për t'u dhënë mundësi studiuesve për të bërë diçka më shumë, për të përfillur edhe ato shkolla e faktorë të cilët më 1968 munguan. Shkenca duhet të mësohet të dëgjojë pikëpamjen ndryshe, vështrimin e tjetrit. Ky jubile ka rëndësi të përveçme në radhë të parë sepse përkujtohet në kushtet e një shoqërie të hapur. Prej kohës kur u organizua kjo konferencë kanë kaluar rreth 40 vjet dhe pas një periudhe kaq të gjatë vjen çasti për të rikapitulluar përfundimet e arritura në dijen shkencore në lidhje me figurën e Skënderbeut.

A ka përplasje mendimesh në lidhje me figurën e Skënderbeut?

Me sa duket diskutimi për vendin e figurës së Gjergj Kastriotit në historinë e Shqipërisë nuk do të mbyllet kurrë. Është krejt normale kur këto diskutime rifillojnë për shkak të fakteve të reja që dalin në dritë në diplomatikë dhe në dokumentalistikë. Por çështja ndërlikohet kur diskutimet rifillojnë për motive joshkencore. Dihet, për shembull, që në Universitetin e Tiranës këto vite janë mbrojtur teza doktoratash që kanë në thelbin e tyre pyetjen nëse shqiptarët kanë ditur ta zgjedhin drejt figurën strumbullar rreth së cilës kanë ndërtuar kështjellën e historisë së tyre. Thënë më thjesht, për herë të parë është vënë në dyshim nëse Skënderbeu shpreh identitetin historik të shqiptarëve dhe është shtruar pyetja nëse do të kishte qenë më mirë që arbërit, dhe pas tyre shqiptarët e sotëm, të kishin zgjedhur si hero-model Ballabanin. Sipas këtyre studiuesve, të cilët së fundmi jorastësisht kanë zgjuar dhe mendimin kritik të shkrimtarit I. Kadare, nëse arbërit do të kishin parapëlqyer Ballabanin dhe Shqipëria nuk do të kishte vendosur të luftonte me osmanët, atëherë vendi ndoshta do të ishte zhvilluar më shumë dhe fati i kombit shqiptar do të kishte marrë një rrjedhë më fatlume. Sipas këtyre dijetarëve, renegati i vërtetë në historinë e Shqipërisë nuk është Ballabani, por Skënderbeu, i cili, duke iu kundërvënë oborrit sulltanor, shkeli mbi shansin e vendit të tij, të cilin perandori e kishte me sy të mirë. Ky arsyetim të çon në përfundimin kontravers se qendresa që bëri Skënderbeu ishte e dëmshme për Shqipërinë. Në fakt, teza të tilla nuk janë krejt të reja. Në mbarim të luftës antifashiste, kur u shtrua problemi i ngritjes së një monumenti për Gjergj Kastriotin, ka pasur udhëheqës politikë, madje liberalë-reformatorë, të cilët, duke iu përmbajtur "parimit të vlerësimit klasor të figurave historike", janë shprehur se "tek e fundit Skënderbeu një bej ka qenë". Pavarsisht se kjo tezë së jashtmi duket për të qeshur, në dije ajo duhet marrë seriozisht, sepse ky është vetëm fillimi, sikurse ndodh me të gjitha tezat e dyshimta, të cilat si hap i parë mbillen në shkencë përmes figurash ndërmjet shkencës dhe politikës dhe me kalimin e kohës zënë vend serioz e qendrojnë serbes ballë për ballë. Në kushtet e lirisë së kërkimit akedemik-universitar janë hapur edhe debate të tjera, pjesa më e madhe të zonës së para-shkencës, një prej të cilëve është nëse Skënderbeu duhet të quhet hero i gjithë shqiptarëve, të krishterë e myslimanë së bashku, apo vetëm hero i të krishterëve. Sido që kjo duket absurde, fakt është se debati është zhvilluar edhe prej njerëzish të shkencës. Pak më tej këtij debati gjendet një tjetër diskutim, nëse me nocionin "arbër" duhen kuptuar gjithë shqiptarët, apo vetëm ajo pjesë e tyre që refuzoi islamizimin, që rikthen në vëmendjen e dijes çështje të karakterizimit të identitetit historik të shqiptarëve, madje edhe të një fragmentarizimi të këtij identiteti. Këto vite jashtë vendit janë botuar studime monografike që veçojnë "tre identitete

shqiptare”, sipas grupimit fetar të tyre. Autorët e këtyre studimeve nuk mund të qortohen nëse vetë dijetarët shqiptarë ndahen në vlerësimin e etnonimit “arbër” dhe të rolit konvergjent të figurës së Skënderbeut. Kryezot i arbërve, ai është i pari që arriti t’i bashkojë shqiptarët në një besëlidhje. Të gjitha këto janë shqetësime për albanologjinë, por shqetësimi më i madh është ai i “shembjes së miteve”, në emër të “emancipimit të popullit”. Të gjitha vendet ish-komuniste kaluan nëpër rrugën e vështirë të “shembjes së miteve”. Por asnjë popull nuk rrënon vetveten, duke shkukur referencat e historisë, sikurse ka ndodhur me një pjesë të shqiptarëve. Nuk ka popull që të mos ketë ide-mit, apo hero-mit. Hebrejtë e përballuan mbrapshtinë e fatit historik me idenë mit të “Torah”, se ata janë “populli i zgjedhur i Perëndisë”. Serbët e mbajnë veten me kurajë edhe në momentet më të vështira duke i rritur brezat me filozofinë se “ne fitojmë në luftë dhe humbim në paqe”. Rusët parvjet ia mbuluan me lule përmendoren Pushkinit deri në pikën më të lartë të saj. Por në mëmëdheun tonë është shumë më e lehtë të vësh përpara mitet dhe të ngresh mbi to emrin e rebelit. Ajo që mund të thuhet me siguri është se gjendja e dijes mbi figurën e Skënderbeut nuk është edhe aq përfundimtare. Rëndësinë 600-vjetorit ia shtojnë edhe burimet e reja arkivistike që Arkivi Qendror Shtetëror ka mundur të sigurojë, si dhe letërsia dokumentare burimore që vjen për herë të parë në bibliografinë albanologjike prej kërkuesve të lirë, midis të cilëve do të veçoja kolanën e prof. Kristo Frashërit, që përbëhet nga 10 vëllime, kryesisht dokumente, pjesa më e madhe e pabotuar. Tre vëllimet e parë të kësaj kolane i përkasin periudhës para se Marin Barleti të shkruante historinë e tij të jetës dhe bëma të Skënderbeut. Arkivi Qendror Shtetëror gjithashtu gjatë këtij jubileu ka siguruar për herë të parë kopje dokumentesh të rralla, thuajse nga të gjitha arkivat, bibliotekat dhe muzeumet europiane. Në fillim të këtij viti Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave iu drejtua me një manifest solidariteti të gjitha këtyre institucioneve dhe prej pjesës më të madhe të tyre kemi marrë jo vetëm informacion për dokumentet që na interesojnë, por edhe kopje të tyre, të cilat, nga pikëpamja shkencore, kanë të njëjtën vlerë si dhe origjinali. Vetëm nga arkivat spanjole bashkëpunëtorët tonë kanë siguruar rreth njëmijë fletë dokumente të mikrofilmuara që i takojnë periudhës sa Gjergj Kastrioti që gjallë. Vetëm ky fakt ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Pa hyrë në përmbajtjen e tyre, ne mësojmë se në kanceleritë e mbretërisë së Pirenejve emri i heroit kombëtar të shqiptarëve ishte emri i një protagonistit të historisë, që e kishte fituar përmasën e vet ndërkombëtare ende pa hyrë në librat e historisë. Qindra, për të mos thënë mijëra dokumente të një rëndësie të dorës së parë kanë ardhur nga Arkivi Sekret i Vatikanit, nga arkivat e Romës, të Napolit, të Venecias, të Firences, nga Biblioteca Laurenziana dhe Museo Correr, nga biblioteka e Grottaferrata-s, nga arkivat dhe bibliotekat kroate, hungareze, austriake. Të gjitha këto burime e dokumenta të reja, që vijnë në shërbim të

shkencës jo rastësisht në këtë 600-vjetor, do të shërbejnë për të hedhur më shumë dritë në lidhje me figurën e Skënderbeut, madje do të guxojnë të thoshin për të njohur anë të mbetura në hije të personalitetit të shumanshëm të kësaj figure.

A është libri “Historia e Skënderbeut”, shkruar nga Marin Barleti një panoramë e plotë dhe e qartë mbi figurën e Skënderbeut apo ka edhe ajo mangësitë e veta?

Diskutimit nuk i ka shpëtuar edhe vlera e librit monumental të Barletit, madje tani së voni ka dalë edhe një diskutim i ri, nëse Marin Barleti është vetë arbër apo një prift kronikan misionar i Perëndimit, një vizitator apostolik, një baiulus-delegat i kancelerive të shteteve të krishtera. Ata që e shtrojnë këtë pyetje përmendin faktin se në librin e tij Barleti flet për “tanët” dhe “kundërshtarët”, por ai nuk shprehet drejtpërsëdrejti nëse me “tanët” nënkupton “arbërit”, shqiptarët, apo në tekstin e tij “tanët” ka kuptimin “të krishterët”. Prej këndeje ka nisur dhe diskutimi nëse Marin Barleti ishte shqiptar apo i huaj. Sa i takon veprën e Barletit, ajo është shkruajtur tërësisht në stil dhe frymë humaniste, në stilin e letërsisë heroike monumentale të Rilindjes Europiane, mbështetur në kultin e njeriut të fuqishëm, të atij lloj heroi që e ka fatin e tij në dorë, që e bën vetë fatin e tij. Për letërsinë historike të asaj kohe Skënderbeu ishte personazhi i gatshëm i përkryer. Ai mishëronte të gjitha tiparet që i duheshin një veprë të shkruar në frymën e humanizmit. Pikërisht kjo është edhe arsyeja e përmasës së jashtëzakonshme europiane dhe ndërkombëtare që mori kjo veprë me shpejtësi të paparë në Perëndim. Me veprën e Barletit për herë të parë letërsia shqiptare mori një përmasë të tillë ndërkombëtare dhe për këtë njerëzit shqiptarë duhet t’i jenë mirënjohës. Ajo veprë ishte tipike humaniste dhe Skënderbeu ishte një hero tipik humanist. Do të duhej të kalonin rreth pesë shekuj që letrat shqipe të njihnin një rikthim të suksesshëm të kësaj përmasë në Europë dhe në botë, kësaj radhe me anë të veprës së I. Kadaresë. Ka pasur edhe shqiptarë të tjerë të famshëm, por në pjesën më të madhe të rasteve kanë ndritur si fenomene të një kulture të madhe, jo të trashëgimisë shpirtërore të njerëzimit. Aleksandër Moisiu, për shembull, u bë një model i kulturës gjermanike, sikurse Sami Frashëri ishte për dekada të tëra dhe mbetet edhe sot një princ i orientalistikës. Roli i Barletit në europeizimin e figurës së Skënderbeut është i padiskutueshëm. Shumë të tjerë që do të shkruanin më pas për Skënderbeun do të mbështeteshin te Barleti. Edhe Noli, në librin e tij monografik, me të cilin mbrojti titullin “doktor në shkencat historike”, përgjithësisht ndjek Barletin (ndërsa në poemën simfonike kushtuar Skënderbeut sundojnë motivet liturgjike të Ungjillit sipas Mateut). Nëse do të

flisnim edhe për “dëme” që vepra e Marin Barletit mund të ketë shkaktuar, këto “dëme” do të shiheshin në faktin se një farë mënyre ai jo vetëm e dominoi dhe vazhdon ta dominojë mendimin historiografik për këtë figurë, por madje “e ngriu” atë në një performancë fikse. Europa e njeh Skënderbeun sipas imazhit që Barleti krijoi dhe këtë imazh është vështirë ta modifikosh. Për mendimin tim, “dëmi” më i madh që i ka ardhur ndërgjegjes shqiptare prej Barletit është mënyra se si është përshtatur për shkollën dhe arsimin. Grekët e vjetër kaluan prej “kultit të fuqisë” tek “kulti i mençurisë” qysh në luftën e Trojës. Fitorja e akejve arriti mbasi kishte dështuar simboli i fuqisë trupore, Akili. Atëherë i erdhi radha heroit të dijes, Odiseut, dhe Troja u pushtua. Kalimi prej heroit model të kultit të fuqisë fizike tek heroi model i kultit të mençurisë përfaqësojnë shkallë të njëpasnjëshme të progresit të mendësisë njerëzore. Tek eposi shqiptar i kreshnikëve Muji zgjedh fuqinë, por heroi i dytë, Halili, është simbol i bukurisë. Në figurën e Gjergj Kastriotit shkolla dhe arsimi kanë kërkuar dhe vazhdojnë të kërkojnë heroin që me një të luajtur të shpatës “njqind krena i ka pre”. Në të vërtetë heroi kombëtar i shqiptarëve e arriti lavdinë e tij me zotësinë për të ndërtuar aleanca të brendshme e të jashtme, për të bërë politikë me të gjithë faktorët që mund të vinin në konvergencë. Në romanin e tij “Kështjella” I. Kadare pikërisht këtë mendësi synoi t’u ofronte shqiptarëve. Ai shkroi romanin e “heroit të papranishëm”, romanin ku Skënderbeu nuk shihej gjekundi të vringëllinte shpatën, dhe megjithatë arbërit arrinin të ishin fitimtarë. Ajo që i bënte ata të fitonin ishte fryma e tij përbashkuese, që ne e kemi edhe në himnin kombëtar.

Vijon nr tjetër...

intervistoi: Albert Hitoaliaj

07.10.2005

BOTIME të Ministrisë së Mbrojtjes

Faqja e Gazetës "USHTRIA", Kryeredaktor: Bardhyl Gostnishi



Botim Qëndror i
Ministritsë së Mbrojtjes

Gazeta

USHTRIA

► Ministria e Mbrojtjes ► Botime ► Revista Mbrojtja

Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake

► Faqe e parë
► Misioni
► Legjislacioni
► Struktura
► Revista Mbrojtja
► Gazeta Ushtria
► Botime të reja
► Njoftime
► Kontakt
► Linke

Qendra e Shtypit,
Botimeve dhe
Përkthimeve Ushtarake

DREJTOR:

Ded Kola

tel: 226701/3099

Redaksia e **LIBRIT**

Kryeredaktor:
Mina QIRICI

"LUFTËTARI I ÇELIKTË"

Studentët ushtarakë, sfida e vështirë e liderit të trupës

Kjo stërvitje, e standarteve West Point-it, do t'u japë kandidatëve të UU "Skënderbej" besimin e duhur për të komanduar trupat >>>



John E. Bushyeed, shefi i ekipit të arsimimit të SAIC: "Kadetët që po trajnohen në stërvitjen "Luftëtari i çeliktë", kanë arritur standarte më të mira të mundshme"

SPECIALE

Mediu: "Ju, pjesa reale e Shqipërisë për t'u antarësuar në NATO"

Niset drejt Mosulit kontigjenti i 6-të i komandove shqiptare.

Detyra që ju do të kryeni është e vështirë, por si unë dhe komandantit tuaj, ashtu dhe prindërit dhe familjet tuaja jeni të bindur se këtë detyrë do ta përmbushni me sukses.

BUNDESWEHR-i

Bundeswehr, 50 vjet

tel: 226701/3099

Gazeta **USHTRIA**
Kryeredaktor:
Bardhyl Gostnishti

tel: 226701/3099

Revista **MBROJTJA**
Kryeredaktor:
Prof.Dr. Elmaz Leci

tel: 226701/3099

Reis: „ShBA, mirënjohëse Shqipërisë“

Ndjehem tejet e nderuar që me jepet rasti të flas në një ngjarje kaq të rëndësishme. Që marr pjesë këtu sot është vërtetë privilegj për mua. Ne jemi sot këtu për të nderuar dhe për të përshëndetur 120 pjesëtarët e njësisë tuaj elitë të komandove. Ky rrotacion shënon ceremoninë e 6-të të mbajtur që nga koha që komandot shqiptare filluan të shërbejnë përkrah forcave të Koalicionit, në Irak.

Përfundon me sukses stërvitja e përbashkët “Eagle SAR 2005”

Të premtën e kaluar, në Regjimentin e Helikopterëve, Farkë u zhvillua Dita e Personaliteteve të Shquar, si dhe ceremonia e përfundimit të stërvitjes së përbashkët e kërkim-shpëtimit “Eagle SAR 05”. Me këtë rast morën pjesë zv.ministrja e Mbrojtjes Zana Xhuka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral lejtnant Pëllumb Qazimi, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, ambasadorë dhe atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të SAIC-ut dhe të DIE-s, ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes,

Vlerësohet roli i FA në luftën kundër terrorizmit

Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, priti në një takim të veçantë Zv.asistenten e Sekretarit të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, Rosemary di Carlo. Në takim ishte e pranishme edhe Ambasadorja e SHBA-s në Tiranë, Marcie Reis. Zonja Rosemary di Carlo në fjalën e saj vlerësoi gjendjen në rajonin tonë dhe rolin pozitiv e stabilizues që luan Shqipëria, angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në luftën kundër terrorizmit, duke u ndalur sidomos në kontributin që japin trupat tona paqeruajtëse për mbrojtjen e paqes dhe lirisë në Irak, Afganistan, Bosnje-Hercegovinë etj.

- **[Petrit KARABINA ZV. MINISTER I MBROJTJES I REPUBLIKES SE SHQIPERISE](#)**
- **[Gjeneral Peter Pace merr zyrtarisht detyrën](#)**

garantim i suksesshëm i paqes

Këtë vit festojmë përvjetorin e 50-të të Bundeswehr-it dhe nën moton “Të vendosur për paqen” nderojmë sot historinë e suksesit të një ushtrie në demokraci.

NJOFTIM

[Njoftim i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore](#)

Në kuadrin e bashkëpunimit me SHBA, Ministrisë së Mbrojtjes i ofrohen të drejta studimi për Akademinë Ushtarake të SHBA-së (Akademia West Point, Akademia e Forcave Ajrore, Akademia e Forcave Detare).

PORTRETE

Maksim Rustemi,
[kapteri komando që shkon në Irak për herë të dytë](#)

Besnik Sokoli,
[majori komando që shkon në Irak për herë të parë](#)

- **[Ministri Mediu pret Ambasadorin e Konfederatës Zviceriane FA zvicerane, ndihmë të vazhdueshme për FA shqiptare](#)**
- **[Ministri Mediu pret Ambasadorin e Mbretërisë së Belgjikës Jean De Rnyt FA në rrugë të mbarë drejt](#)**

- **[“Eagle SAR-05” koordinim i saktë dhe sinkronizim i komandim-kontrollit](#)**
- **[Kontribut i të gjithëve për realizimin e objektivave të mbrojtjes](#)**
- **[Kursi i oficerit të SHP, program i](#)**

- **[Këtë vit mbërrin një Skënderbe tjetër](#)**
- **[Kualifikimi në kolegjet britanike, ndihmesë për reformat në FA](#)**
- **[Rinovim i marreveshjes teknike të bashkëpunimit shendetesor ushtarak](#)**

[antarësimit në NATO](#)

[ri bashkëkohor](#)

Arkivi i Gazetës "USHTRIA"

KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
29.07.2005	26.08.2005	30.09.2005			
22.07.2005	19.08.2005	23.09.2005	07.10.2005		
	12.08.2005	16.09.2005	14.10.2005		
	05.08.2005	09.09.2005			
		02.09.2005			

Gazeta e dates 14.10.2005



▶ Faqe e parë
▶ Misioni
▶ Legjislacioni
▶ Struktura
▶ Revista Mbrojtja
▶ Gazeta Ushtria
▶ Botime të reja
▶ Njoftime
▶ Kontakt
▶ Linke

Këtë vit mbërrin një Skënderbe tjetër

...vijon nga numri i kaluar

A ekziston një Skënderbe para dhe pa Barletin?

Me burimet dokumentare që zotërohen, mund të thuhet në mënyrë të sigurt që po, ekziston një Skënderbe para dhe pa Barletin. Në koleksionin e Kristo Frashërit, sikurse përmenda, tre vëllime i përkasin periudhës para se Barleti të shkruante veprën e tij. I pari prej vëllimeve, sikurse është shprehur vetë autori, mund të mbante titullin konvencional "Skënderbeu me dorën e tij", sepse përmban korrespondencën që ka dalë nga kanceleria e prijësit të arbërve, ose fragmente letrash të cituara në ligjëratë të drejtë prej figurave të historisë politike me të cilët Gjergj Kastrioti këmbente kumte. Ky është një vëllim i pasur me të dhëna biografike dhe autobiografike për figurën e Skënderbeut. Me shumë interes janë burimet arkivistike dhe historike që vijnë nga vende tejet të largëta, ku jehona e veprës së Barletit ose mbërriti me vonesë, ose mbërriti me ndërmjetësinë e një autori apo gjuhe tjetër, sikurse janë, për shembull, burimet që i ka dhuruar arkivit tonë albanogu danez Bjoern Andersen. Dokumente të tilla, jashtë influencës së Barletit, ose me një influencë të tërthortë dhe në formë jehone të veprës së tij, janë gjetur deri në Islandë. "Skënderbeu para dhe pa Barletin" mund të ishte objekti i një konference shkencore më vete. Jo për të nënçmuar veprën e Barletit, por për të zbatuar atë parim themelor që e ka bërë historikisht të vërtetën më të vërtetë dhe që humanistët europianë në kohën e Reformës e shprehnin në sloganin "të kthehemi tek burimi". Vetë Barleti flet për "kronikat tona", pra, për burime para veprës së tij. Duke zbatuar këtë parim do të kalohej prej romantizmit në realizëm. Barleti thotë, për shembull, që kështjella e Shkodrës mori emrin Rozafa sepse ishin dy motra (apo një vëlla e një motër), Roza dhe Fa, që e themeluan. Në stilin romantik kjo është bukur e tingëllueshme. Por

Qendra e Shtypit,
Botimeve dhe
Përkthimeve Ushtarake

DREJTOR:
Ded Kola
tel: 226701/3099

Redaksia e **LIBRIT**

Kryeredaktor:
Mina QIRICI
tel: 226701/3099

Gazeta **USHTRIA**
Kryeredaktor:
Bardhyl Gostnishti

tel: 226701/3099

Revista **MBROJTJA**
Kryeredaktor:
Prof.Dr. Elmaz Leci

tel: 226701/3099

nëse çështja do të shtrohej në një rrafsh të kritikizmit historik, atëherë do të duhej të përfillej fakti që Shën Sergji dhe Baku, që ndërtuan qysh në fillimet e krishtërimit të ligjshëm kishën e tyre buzë Bunës, kishin si vendlindje pikërisht Rozafa-n e izraelitëve të moçëm. A mund të shpërfilllet ky fakt? Kështu do të ndodhte edhe me plot çështje të tjera.

Dokumentacioni i ri në lidhje me figurën e Skënderbeut nëse konsiston?

Pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve janë të panjohura. Një pjesë tjetër janë deri-diku të njohura, por nuk janë prekur kurrë nga shkencëtarët shqiptarë në formën e dorëshkrimit. Një pjesë e tretë janë pjesërisht të njohura, ashtu në mënyrë fragmentare dhe ndonjëherë edhe të deformatuara, si i ka botuar dikush dikur jashtë Shqipërisë. Para disa ditësh kam marrë një letër nga drejtori i arkivit të Aragonës, i cili më njofton se në atë arkiv ruhen 42 dokumente origjinale që i ka shfrytëzuar e botuar Jovan Radonic më 1942 në librin e tij "Gjergj Kastrioti dhe historia e Shqipërisë në Mesjetë", mirëpo, sikurse shkruan kolegu spanjoll, në librin e tij Radonic këto dokumente ose i ka shkurtuar, ose i ka interpretuar subjektivisht, ose ndoshta edhe i ka shtrembëruar. Ne do të kemi mundësinë që t'i kemi të plota këto dokumente dhe historianët do të jenë ata që do t'u japin vlerën e merituar. Vetëm pak ditë më parë ne morëm pëlqimin nga autoritetet qeveritare që të blejmë një kopje të "Statuteve të Drishtit", që janë përmbyllur në vitin 1466, kur Gjergj Kastrioti ishte gjallë. "Statutet e Drishtit" madje janë konfirmuar nga kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli, që ishte njëherësh dhe kryekancelari i Gjergj Kastriotit, i mbiquajtur në shkrimet e hershme historike "Epirus Princeps", "Epirus Victor", "Dominus Albaniae", madje edhe "Rex Albaniae". "Statutet e Drishtit", një kopje të të cilave presim që shumë shpejt të na e dërgojë Dr. Ivan Boserup, që drejton divizionin e dorëshkrimeve në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës, në vitin 1971 janë botuar pjesërisht, sipas shënimeve që pati mbajtur dikur albanologu Milan Shuflaj. Por tjetër gjë është të kesh gjithë dorëshkrimin, ku ka edhe miniatura, ka edhe anëshkrime, ka edhe korrigjime dhe elementë të tjerë të kulturës së shkrimit dhe të traditës së të drejtës. Ardhja e këtij kodiku dhe studimi i tij herët a vonë do të shërbejë si shkas për një reflektim të përgjithshëm për historinë e së drejtës tradicionale në Shqipëri dhe sidomos për historinë e raporteve të së drejtës urbane me atë agrare. Vetë fakti se qytetet shqiptare edhe në vitin 1466, kur Gjergj Kastrioti pas pak vitesh do të ndahej nga jeta, vazhdonin të hartonin statute të qeverisjes së lirë, ka një domethënie të jashtëzakonshme. Ky statut është pjesë e traditës qytetare shqiptare, e cila reflektohet edhe në statutet e Tivarit, Ulqinit, Durrësit, Danjës, Krujës e Shkodrës. Këto statute janë hartuar ndërmjet shekujvet XIII - XV dhe përmbajnë fytyrën europiane të Shqipërisë, të një vendi i cili i

ndërtonte marrëdhëniet mbi kushtetuta qytetare. I vetmi statut i botuar në Shqipëri është ai i Shkodrës, nën kujdesin e Prof. Dr. Pëllumb Xhufi dhe të Dr. Lucia Nadin. Statuti i Danjës, që ruhet në arkivat kroate, ka mbi 550 nene dhe përfaqëson një kushtetutë më vete. Statuti i Zarës së Arbëreshëve, që është botuar latinisht e kroatisht nga studiuesit e Zagrebit, ka disa qindra faqe. Brenda tij është një histori e tërë etno-zakonore dhe kulturore për t'u zbuluar. Korrespondenca zyrtare e Gjergj Kastriotit me princërit arbër, letërkëmbimi me mbretin e Aragonës dhe të Napolit, me Selinë e Shenjtë; vulat, stemat, emblemat, marrëveshjet, kredencialet, statutet, janë dokumentet më të rëndësishme për të cilat ky jubile që po mbyllet mund të kontribuojë.

Është krijuar përshtypja se institucioni që ju drejtoni ka pasur njëfarë tërheqjeje nga veprimtaritë jubilarë kushtuar këtij 600-vjetori?

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave është i pari institucion që u kujtua se viti 2005 është viti i 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit. Nja dy muaj na u deshën të bindim institucionet se ishte pikërisht viti 1405 viti i lindjes së heroit kombëtar të shqiptarëve. Arkivat përgatitën projekt-vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e këtij viti si vit të Gjergj Kastriotit. Këtë ide e përvetësoi i pari presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova, i cili e dekretoi pa vonesë shpalljen. Nga fillimi i këtij viti edhe qeveria e Shqipërisë e shpalli vitin 2005 vit të Skënderbeut. Duke pasur përgjegjësinë e propozuesit, ne nuk mund të tërhiqeshim. Por po ashtu na është dukur e tepërt të nxisim nisma që kanë po aq lidhje me 600-vjetorin e lindjes së Skënderbeut, sa edhe me fillimin e gjelbërimit në pranverë, shpyllëzimet dhe ripyllëzimet, shtegtimin e zogjve etj. Një jubile i tillë kthehet pas një shekulli dhe prandaj gjithçka duhet të jetë dinjitoze, ose më mirë të mos jetë fare. Figura e Gjergj Kastriotit është një qokë themelore në kapërcyell prej periudhës arbërore tek ajo shqiptare, prej Rilindjes së parë (europiane) tek e dyta (shqiptare), prandaj meriton nderet e shkallës më të lartë. Ne do të përpiqemi ta shprehim këtë nderim pa shumë fjalë me ekspozitën "Gjergj Kastrioti - figurë e Rilindjes Europiane", që do të hapet nën kujdesin e Kryeministrit në muajin nëntor.

Çfarë stemash dhe vulash ka pasur në përdorim Skënderbeu?

Stemat kanë qenë attribute të familjeve patronimike. Në këtë kuptim, stemat janë të lidhura me mbiemrat e familjeve të bujarisë arbërore. Kjo do të thotë se mund të flitet për stema të Kastriotëve, por jo të Skënderbeut. Njëra prej tyre, që përfaqëson një shqiponjë dykrerëshe me një yll gjashtëcepësh në krye, është e mirënjohur si stemë e Kastriotëve. Në arkivat e Kroacisë është gjetur dhe një stemë tjetër, e mbështetur në të njëjtin motiv, shqiponjën me dy krerë, por me stilizim tjetër dhe me përbërje e kompozim heraldik të ndryshëm. Mendohet se kjo ishte stema që Gjergj Kastrioti përdorte si prijës i arbërve, pasi mori kryesimin e Lidhjes së Lezhës. Në të dyja këto stema sundojnë elementët bazë të heraldikës bizantine, duke përfshirë shqiponjën

dykrerëshe. Duket se tek paraardhësit tanë, përfshirë Kastriotët, ka ekzistuar njëfarë vetëdije e brendshme perandorake, e cila ngjan se edhe sot herë-herë shpërthen nga nënvetëdija kombëtare. Në traditën mitologjike shqiptare shqiponja nuk ka ndonjë rol totemi. Funksione totemi në mitet e lashtësisë iliro-shqiptare kanë dhia dhe gjarpëri. Ilirët e quanin veten bij të gjarpërit dhe shqiptarët, pasardhësit e tyre, gjarpërin e quajnë "ama e votrës". Në eposin e kreshnikëve dy kryeheronjtë e marrin fuqinë nga zanat e malit dhe këto të fundit tek "tri dhitë briarta". Shqiponja nuk ka ndonjë atribut mbrojtës-totemik tek iliro-shqiptarët. Identifikimi i shqiptarëve në dy shekujt e fundmë si "bij të shqipes" shpreh thjesht një romantizëm të vonuar. Jo vetëm që shqiptarët nuk kanë ndonjë lidhje të gojëdhënës kombëtare me shqiponjën, por as emri i Shqipërisë nuk mund të shpjegohet me këtë leksemë. Emri i Shqipërisë është përdorur jo më herët se para tre shekujsh dhe lidhet me ndajfoljen "shqip", në kuptimin fillestar me domethënien "qartë", sikurse tek rrënja latine "explicitus". Prandaj stemat me shqiponjë dykrerëshe të Kastriotëve duhen parë në kontekstin e qytetërimit bizantin, ku përfshihej edhe bota arbërore në fund të mesjetës. Ndërsa stema e tretë, e cila thuajse nuk njihet fare në mjediset shqiptare, në kuptimin e plotë të fjalës mund të cilësohet stemë e Skënderbeut, sepse është në tërë elementët përbërës të saj e lidhur me protagonizmin e tij historik. Kjo stemë përmban një shqyt samit, në fundin e të cilit shihet hënëza e holluar e ish-perandorisë osmane, në pozicion të përmbysur, mbi të cilën qendron vertikalisht një thikë ngadhënjyese, që mbahet nga një dorë pjesërisht e pranishme në fushën e stemës. Të gjitha këto janë të mbivendosura në një sfond blu. Ka mundësi që kjo stemë, e cila dallon mjaft prej heraldikës bizantine, t'i jetë kushtuar Skënderbeut nga ndonjë piktor italian gjatë vizitës së tij në Selinë e Shenjtë. Në kuptimin e plotë të fjalës, kjo stemë është shprehëse e vlerave të kalorësit mbrojtës të krishterimit. Ndoshta për këtë arsye ajo është më e njohur në Perëndim se në Shqipëri. Stemat kanë pasur funksion identifikues. Përmes stemës njihet se cilët ishin aleatët dhe cila ishte pala kundërshtarë në luftë. Sa i takon yllit gjashtëcepësh që gjendet në stemën e Kastriotëve, nuk qendron teza se mund të jetë shenjimi i yllit hebraik të Davidit. Dihet se jo çdo yll gjashtëcepësh përfaqëson yllin e Davidit. Në rastin e stemës së Kastriotëve kjo shenjë është pikërisht në vendin që heraldika bizantine e rezervonte për kurorën (edhe sot vendet monarkike kurorën e vendosin në qendër), dhe kjo përforcon edhe një herë idenë se tek shqiptarët mesjetarë ka ekzistuar një ndërgjegje e brendshme perandorake. Nuk është e rastit që shqiptarët u bënë stratiotë të famshëm prej Ballkanëve deri në Pirenej e Britani. Sa u takon vulave të Kastriotëve, gjithashtu janë të njohura të paktën tri (pa numëruar vulën që ruhet në Muzeun Mbretëror të Danimarkës, e cila u paraqit në mjediset shqiptare për afro tre muaj dhe asnjë studim nuk u bë rreth saj - madje asnjë

historian nuk rezulton të ketë shkuar për ta ekspertuar). Dy nga këto vula përdoren nga kanceleria e Gjergj Kastriotit, që kryesohej nga arkipeshkvi i Durrësit Pal Engjëlli. Këto dy vula ishin për t'u përdorur për të certifikuar korrespondencën zyrtare: letrat, kredencialet, marrëveshjet. Vula e tretë përmban në qendër figurën mitologjike të Ledës, në pamje gjysmë të zhveshur, e ngjashme me një sirenë, dhe përdorej vetëm për korrespondencën private. Në kuptimin arkivistik vulë quhet një mjet certifikimi që e ka lënë gjurmën e vet në një dokument. Nëse një mjet i tillë nuk rezulton ta ketë lënë së paku një herë gjurmën mbi një dokument, vulë nuk mund të jetë. Në burimet arkivore që kanë hyrë kohët e fundit në AQSH gjendet dhe imazhi i vulave të Kastriotëve në pllakëzën prej dylli, që përmyllte letrat. Prandaj vulat kërkohen atje ku shkonin dokumentet. Në ekspozitën arkivistike që do të hapet së afërmi arkivat e Shqipërisë do të paraqesin edhe imazhe të këtyre vulave ashtu si janë ruajtur në dokumente.

A ekziston mundësia e ardhjes së armëve të Skënderbeut nga Muzeu i Vjenës për t'i vizituar shqiptarët në këtë përvjetor?

Mendoj se tani është shumë vonë për të pretenduar realizimin e këtij qëllimi. Reliktet e Gjergj Kastriotit (mburoja, përkrenarja dhe njëfarë mburoje e kalit) nuk kanë dalë ndonjëherë nga Muzeu i Armëve dhe Instrumenteve në Vienë. I pari ka qenë shteti italian ai që i ka kërkuar këto armë e relikte për t'i ekspozuar në vitet 1930, në kuadër të veprimtarive "a la romana" të asaj kohe, por autoritetet austriake nuk e dhanë lejen. Në vitin 1968, në kuadër të përkujtimit të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, janë bërë negociata midis palës shqiptare dhe asaj austriake për këtë mundësi dhe për ndonjë zgjidhje tjetër. Theksoj se është vonë, por jo e pamundur. Dihet se Viena e ka bërë një herë një lëshim historik në dobi të shqiptarëve sa u takon vlerave të tilla të rralla historike. Pas zgjedhjes së Princ Wied-it si trashëgimtar i fronit të Shqipërisë kanceleritë e fuqive të mëdha vendosën të dhurojnë objekte aristokratike për t'i krijuar atij një oborr sipas rangut të tij. Sikurse ka arritur të konkludojë prof. K. Frashëri, Viena perandorake urdhëroi daljen prej Muzeut të Arteve të një portreti të rrallë të Gjergj Kastriotit, që do t'i dhurohej Princ Wied-it. Dihet se ky portret mbërriti deri në Shkodër, por, ndërkaq, princi e kishte dhënë dorëheqjen dhe pastaj gjurmët e korrierit zhduken bashkë me portretin (ose anasjelltas). Ka pasur një çast kur qe arritur një dakordësi parimore për sjelljen e përkohshme të relikteve të Gjergj Kastriotit në Shqipëri, të paktën për një periudhë 6-mujore. Para dy vjetësh, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, kam bashkëbiseduar disa herë me ish-ambasadorin e Austrisë në Shqipëri z. Hans-Dietrich Renau për këtë mundësi. Në përfundim ne arritëm në një pëlqim të përbashkët, që, me angazhimin e autoriteteve të larta të dy vendeve, armët e Skënderbeut të silleshin në Tiranë.

Ambasadori Dietrih-Renau pati konfirmuar se nuk kishte pengesa nga Viena për ta plotësuar këtë nismë, por paraprakisht duhej konfirmuar gjithashtu një kujdestari e lartë shtetërore vendëse dhe duhej përballuar kostoja e sigurimit në udhëtim dhe në ekspozim. Për këtë do të duhej një marrëveshje e karakterit ndërqeveritar, e cila, për pakujdesi, nuk u arrit. Në atë kohë unë i pata drejtuar një relacion të hollësishëm Qeverisë, por si përgjigje, nga këshilltarët kompetentë mora vërejtjen se "nuk ishte në funksionin tim të merresha me iniciativa të tilla". Në vitin 2003 ekzistonte një vullnet i qartë nga pala austriake për të lejuar ekspozimin e relikteve të Skënderbeut në Shqipëri. Por në kohën e duhur autoritetet vendëse nuk i morën përgjegjësitë e veta. Tani nuk jam në gjendje të pohoj nëse ekziston ende një vullnet i tillë. Fakti që nga data 5 deri më 10 tetor në këndin e ekspozimit të relikteve të he ka rëndësi që edhe atje përkujtohet ky jubile.

Ata që i kanë parë këto relikte thonë se shqiptarët do të zhgënjeshin po t'i shihnin në Tiranë, sepse nuk u përgjigjen përmasave që ata kanë në imagjinatën e tyre për Skënderbeun...

Kjo është e vërtetë. Armët dhe reliket e Skënderbeut janë të përmasave të një njeriu krejt të zakonshëm, me trup mesatar. Por kjo nuk do të thotë detyrimisht se Gjergj Kastrioti ka pasur përmasat që i përgjigjen madhësisë së armëve të tij. Deri më sot, për arsye të panjohura, nuk është shtruar për diskutim çështja se çfarë karakteri kanë këto armë. Në mesjetë, sidomos në kohë luftërash, triumfesh, heroizmi; kalorësit prijës, familjet e mëdha patronimike, nuk kishin vetëm armë luftime, por edhe armë zbukuruese, për të dekoruar sallonet e tyre aristokratike; si dhe, natyrisht, armë trofe, të rrëmbyera prej kundërshtarëve në dyluftime ose beteja. Nëse nuk kemi arsye ta përjashtojmë nga figura e Skënderbeut edhe fuqinë e tij si luftëtar, afërmendësh që duhet pranuar se ai kishte edhe armë trofe, armë të fituara në luftë. Në rastin e armëve që ruhen në Muzeun e Armëve dhe të Instrumentëve të Vienës përjashtohet që të jetë fjala për armë trofe, për shkak se përkrenarja përmban si shenjë dalluese brirët e dhisë, që, sikurse e përmenda, përfaqësojnë një totem për shqiptarët. Por nuk përjashtohet diskutimi i dytë, nëse këto ishin armë luftime apo armë zbukuruese dhe së fundmi nëse ishin armë të përdorura në luftë apo të imituara sipas modelit të atyre të përdorura në luftë. Por edhe në ndodhtë që shqiptarët të zhgënjehen nga mospërputhja midis përfytyrimit të tyre për heroin dhe përmasave reale të armëve të tij, kjo nuk do të kishte asgjë të keqe. Zhgënjimin më të madh e sjell "vrasja e heronjve me shkencë".

Emri "Skënderbe" është një titull, është gradë apo ndonjë ofiq oborri në sulltanatin osman?

Morfologjikisht "Skënderbej" është një kompozitë, që përmban një emër të përveçëm (turq.: "Iskander", shqip: "Skënder") dhe një titull të fituar për merita lufte (turq.: "bey", sot me kuptimin "zotni"). Gjergj Kastrioti e kaloi fëmijërinë dhe rininë në oborrin e sulltanit. Natyrisht, atje nuk mund të mbante emrin e pagëzimit, emër "gjauri", sido që perandoria osmane, përmes sistemit të mileteve, i njihte zyrtarisht bashkësitë fetare. I ardhur prej një familjeje fisnike me ndikim në gjithë "sancakun arvanid"; i shquar në shkollën e jeniçerëve dhe pastaj si komandant fushatash në dobi të perandorisë, sulltani nuk mund të zgjidhte për të një emër çfarëdo për ta thirrur si i shkonte fesë së tij të re (në ish-perandorinë osmane, si rregull, të gjithë rishtarët që pranonin besimin islam quheshin "Adul-lah", që ka kuptimin "rob i zotit", dhe vetëm në brezin e dytë mund të përdroreshin emra të tjerë, përveçues). Është fakt se, në fillimet e veta, perandoria osmane nuk ndërhyri në onomastikë dhe toponimi, thjesht i përshtati emrat që gjeti sipas mundësive fonetike të osmanishtes. Mbeti emri i Kostandinopojës tek Stambolli (Instanbul), po ashtu emri i Aleksandrit tek "Iskander". Për sulltanin përdorimi i emrit të Aleksandrit, heroit të lavdishëm të antikitetit, bëmat e të cilit e kishin prekur hapësirën e qëmoçme turko-mongole, nuk kishte ndonjë pengesë, sepse, ndër të tjera, ky emër i takonte parakrishtërit. Duke e quajtur "Iskander-bey", sulltani, në mënyrë eufemike, i mburrte Gjergj Kastriotit jo vetëm trimërinë, por edhe të shkuarën vendëse. Kjo ka qenë tradita: sulltanët nuk jepnin emrin e rishtarit në islam, por emra personalitetesh të shquar. Në fakt, emrin e Aleksandrit sulltanët e kanë dhënë relativisht shpesh për luftëtarët e shquar që i bënin nder perandorisë. Para tri vjetësh, gjatë një vizite në Arkivat Osmane në Stamboll, kur kërkova të më siguroheshin kopje dokumentesh që dëshmojnë veprimtarinë e Skënderbeut, kolegët e mi mikpritës ma kthyen me të qeshur: "Në shekullin e 15-të janë ndonja 40 Iskanderbenj dhe ju duhet të gjeni fillimisht se cili prej këtyre është Iskanderbeu juaj. Për ndryshe kërkimi është thuajse i pamundur". Pikërisht kjo është një nga pengesat kryesore për të identifikuar dokumentet e Skënderbeut shqiptar. Kjo pengesë nuk është vetëm për Skënderbeun, por për gjithë personalitetet shqiptare që kanë vepruar në kuadër të saj, sepse, deri në reformat e Atatürkut, në traditën turko-osmane mbiemri nuk ka ekzistuar. Në vend të mbiemrave përdroreshin ofiqet (bej, aga, pasha, vezir) ose emri i babait. Naim Frashëri, për shembull, në dokumentacionin osman njihet si Naim Mehmet, por në kohën që ka vepruar Naim Frashëri ka pasur disa qindra Naim Mehmetë që shkruanin ose merrnin pjesë në forma të tjera në jetën shtetërore dhe publike. Ndërsa mbiemri "Frashëri", që do të lehtësonte shumë kërkimet, nuk del gjëkund.

Përderisa për të njëjtin person apo ngjarje ekzistojnë versione e të dhëna të ndryshme, ku secila palë ka në dorë faktet e veta dhe i mbron

ato, a mund të quhet historia një shkencë e vërtetë?

Shumësia e interpretimeve dhe mospajtimeve për ngjarje e figura të procesit historik janë një dukuri jopërfundimtare për shkencën e historisë. Në të gjitha "shkencat e fjalës" e vërteta ekziston vetëm në një proces të pandërprerë revizionimi dhe krahasimi. Ka vetëm të vërteta të krahasuara dhe deri në një shkallë të njohjes. Të vërteta absolute ka vetëm në besim. Edhe në shkencat e sakta tashmë ka disa të vërteta, duke iu referuar sistemeve të ndryshme. Ajo që e mundon akoma historinë e Shqipërisë është fakti që ajo është konceptuar thuhet fund e krye si histori lufte. Në të vërtetë, historia e Shqipërisë sikurse çdo histori tjetër, përveç luftërave, duhet të përmbajë edhe historinë e qytetërimit, historinë e kulturës dhe të identitetit kombëtar, historinë e lëvizjes së mendimit. Njerëzit shqiptarë e kanë përjetuar historinë jo vetëm si një histori veprimi, si histori ngjarjeje dhe heroizmi monumental. Qendresa shqiptare është e mirënjohur në botë, por jo aq sa të thuhet se populli shqiptar e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Historia e Shqipërisë e ka për detyrë t'i formojë brezat e rinj me filozofinë se shqiptarët i kanë paraprirë procesit historik jo me zgjatimin e pushkës, bajonetën; por me zgjatimin e shtyllës kurrizore, trurin. Natyrisht që, nëse një histori ndërtohet mbi konceptin se vetëm luftërat meritojnë vëmendje, atëherë prej qendresës së epokës së Skënderbeut deri në kryengritjen ballkanike të vitit 1689 nuk ka gjë për të shënuar, megjithëse pikërisht në këtë kohë lindi shkrimi dhe letërsia shqipe, u shquan protagonistët e lëvizjes reformuese brenda "botës së sanë". Ky koncept shpjegon pse në tekste të historisë së Shqipërisë ka herë pas here pauza të gjata nga një kohë në tjetrën, sepse nuk ka luftëra. Bardët e eposit të kreshnikëve duket kanë pasur një vetëdije më realiste, kur thonë se Halili e njohu Tanushën "kur kemi' pas besë me krajli", domethënë kur kemi pasur paqe me fqinjët. Njëfarë fragmentarizmi shihet edhe për periudhën prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878) deri në kryengritjet e mëdha anti-osmane (1911-1912), megjithëse kësaj periudhe i takon një lëvizje mendimi ku ruhen gjurmat e një prej debateve më të rëndësishëm të ndërgjegjes politike shqiptare, të debatit midis autonomistëve dhe pavarësistëve. Kthimi i vëmendjes tek paqet, puna, kultura e jetesës, shijet, identiteti, stemat, emblemat, vultat, statutet, manastiret, kishat, kodikët, kështjellat, do ta ekuilibronë historinë tonë dhe do ta shkencorizonte përgjithësisht dijen historiografike.

Mos ndoshta është edhe kjo arsyeja që në figurën e Gjergj Kastriotit ne kemi më shumë një hero si një njeri luftëtar?

Pikërisht ky është një prej keqkuptimeve të rënda në një pjesë të historisë së Shqipërisë. "Xhelozia" për t'i mbyllur vlerat e tij vetëm brenda botës shqiptare, hezitimi për të njohur meritat e tij të padiskutueshme si mbrojtës i qytetërimit

të krishterë dhe si kalorës i krishtërimit ("athleta Christi"), shqetësimi se mos ndonjë prej këtyre meritave del mbi atë të karakterizimit si hero kombëtar, ka shkaktuar edhe shmangie nga e vërteta rreth figurës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Ajo që i mungon historiografisë vendëse është vullneti për ta vështruar e vlerësuar Skënderbeun si figurën e një protagonistit të Rilindjes Europiane. Kjo epokë e madhe e historisë së njerëzimit quhet "europiane" sepse asnjë vend europian veç e veç nuk arriti gjithçka, nuk e realizoi në mënyrë të pavarur Rilindjen. Dihet se Italia i dha Rilindjes Europiane pikturën dhe skulpturën; Franca i dha universitetet dhe mendimtarët filozofë; Spanja i dha Servantesin dhe romanin; Anglia i dha Shekspirin dhe tragjedinë; bota gjermanike i dha Martin Luterin dhe reformën kishtarë; Çekia i dha Jan Husin dhe frymën e kryengritjes; Polonia i dha Kopernikun dhe zbulimet në shkencën e fizikës; kurse Shqipëria dhe Hungaria dhanë dy strategë të mëdhenj, pa praninë e të cilëve Rilindja Europiane do të ndihej e gjymtë: Gjergj Kastriotin dhe Janos Huniadin. Duke kërkuar tek figura e Gjergj Kastriotit jo një kreshnik që del prej zgafelle dhe me një shpatë në dorë mbron kufijtë e Arbërisë nga jug në veri, por një strateg, që zbuloi se si një popull i vogël mund të mbrohet prej një perandorie të madhe, se si një mënyrë jetese dhe e organizimit shoqëror e shtetëror përballet me sfidën e një mënyre tjetër të tillë, atëherë do të rezultojë ndryshe jo vetëm vlera historike e kësaj figure, por dhe kontributi i Shqipërisë në tërmetin shpirtëror epokal të Rilindjes Europiane.

A ka dokumentacion që mund të tregojë marrjen peng të Skënderbeut dhe çarjen e tij për studime në oborrin e sulltanit?

Kjo është pjesa më e pambuluar me dokumentacion. Gjergj Kastrioti, kur u mor peng në oborrin e sulltanit, ka qenë vetëm 9 vjeç. Në atë kohë ai ishte një fëmijë si gjithë fëmijët e tjerë, për më tepër një fëmijë fatkeq, i marrë peng, kështu që nuk mund të pritej që historia të ishte e vëmendshme qysh në atë kohë ndaj tij. Ishte ende shumë shpejt, askush nuk e dinte se ai do të bëhej një hero.

Cilët janë titujt që i janë dhënë Skënderbeut nga shqiptarët?

Shqiptarët nuk dihet t'i kenë dhënë ndonjë titull Skënderbeut. Turqit osmanë e quajtën "bej". Në besëlidhjen e Lezhës ai mori pjesë si "primus inter pares" - i parë midis të barabartësh. Megjithatë, nga ky kuvend ai doli si kryetar i besëlidhjes. Ky mund të quhet i vetmi titull që iu dha atij nga shqiptarët. Ndërsa mbretëritë përtej detit, sikurse përmenda, e kanë quajtur "Epirus rex" (mbret i Epirit), "Epirus principes" (princ i Epirit), "dominus Albaniae" (zot i Shqipërisë), "roi d'Albanie" (mbret i Shqipërisë), "Epirus victor" (ngadhënjës i Epirit). Ajo që vlen të veçohet është se ka pasur dy iniciativa papnore për ta kurorëzuar mbret (në atë kohë e për disa shekuj me radhë më vonë i vetmi

autoritet që kishte fuqinë për të kurorëzuar një mbret ishte Papa). Në vitin 1466 Skënderbeu ka vizituar Selinë e Shenjtë (sot rezidenca "Quirinale") dhe gjatë asaj vizite pothuajse ishte paralajmëruar se do të zyrtarizohej kurorëzimi i tij si mbret, gjë që nuk ndodhi, për arsye që edhe sot nuk janë shpjeguar tamam. Një vit më vonë Ati i Shenjtë u nis vetë të vizitojë vendin e qendresës antiosmane dhe të kurorëzojë mbret prijësin e saj, Gjergj Kastriotin, në pamundësi për të përballuar një kryqëzatë të re apo për të sfiduar me një luftë europiane perandorinë e re që kishte dalë në Adriatik, por, për fatin e keq të historisë së Shqipërisë, ai vdiq nga një sëmundje e rëndë në Pulia. Juridikisht Skënderbeu nuk u bë mbret i Arbërisë, por historikisht dihet se për këtë iniciativat u hodhën dy herë. Perëndimi dashamirësinë ndaj Skënderbeut e tregoi edhe me mikpritjen, pranimin dhe vendosjen në rajone homogjene banimi të familjeve të mëdha shqiptare pas vdekjes së tij dhe pushtimit të Shqipërisë.

Kur ka filluar nderimi zyrtar i Skënderbeut në Shqipëri?

Mendoj se kjo fillon me themelimin e urdhërit të Skënderbeut, si udhëri më i lartë që akordonte mbretëria shqiptare për merita atdhetare dhe për kontribute të shquara të të huajve për botën shqiptare. Hapi i dytë i rëndësishëm është konkursi i shpallur në vitin 1937 nga mbreti Zog për ngritjen e një përmendoreje kushtuar Skënderbeut. Në këtë konkurs morën pjesë skulptorë me njohje ndërkombëtare: italianë, kroatë, shqiptarë. Edhe emërtimi që zgjodhi mbretëria për monedhën e vendit ("lek") ishte një formë nderimi për Skënderbeun, në emrin e të cilit ruhej edhe emri i Aleksandrit.

Intervistoi: Albert Hitoaliaj

14.10.2005

BOTIME të Ministrisë së Mbrojtjes